
FJALËFORMIMI I PËREMRAVE TË PACAKTUAR NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE WORD FORMATION OF INDEFINITE PRONOUNS IN ENGLISH AND ALBANIAN

ESMERALDA SHERKO & ARJAN SHUMELI

Departamenti i Gjuhës Angleze, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Tiranë, SHQIPËRI

E-mail: aldasotiri@yahoo.com

AKTET VI, 4: 412 - 415, 2012

PERMBLEDHJE

Ky punim fokusohet mbi fjalëformimin e përemrave të pacaktuar në gjuhën shqipe dhe angleze. Metoda e përdorur në këtë punim është bazuar në krahasimin dygjuhësh. Punimi përqendrohet te përemrat e pacaktuar në FGJSSH dhe përkthimin e tyre. Klasa e përemrave të pacaktuar në gjuhën shqipe është e larmishme. Për sa i përket fjalëformimit përngjitja dhe konversioni shfaqin prirje për ta pasuruar më shumë këtë klasë, ndërsa në gjuhën angleze përemrat e pacaktuar janë më të paktë. Rugët e formimit të përemrave të pacaktuar përkojnë në të dyja gjuhët. Në gjuhën angleze pjesa dërmuese e tyre janë të përbërë dhe pavarësisht nga kuptimi i shumësit që japin, shoqërohen nga folja në numrin njëjës. Gjatë përkthimit të tyre një përemri të pacaktuar të shqipes mund t'i korrespondojnë disa në gjuhën angleze. Ka raste kur, në **gjuhën angleze** përkthimi i përemrave të pacaktuar të shqipes korrespondon me pjesë të tjera të ligjëratës.

Fjalët kyçe: fjalëformim, përemër, i pacaktuar, gjuhë shqipe, gjuhë angleze.

SUMMARY

This paper analyzes word formation of indefinite pronouns in English and Albanian. The method used in this study was based on a comparative overview between English and Albanian. The study focuses on indefinite pronouns in the Dictionary of Albanian Language and their translation. The class of indefinite pronouns in Albanian is rich. As far as word formation is concerned compounding and conversion trend to enrich this class more, whereas in English there are less indefinite pronouns. Word formation techniques overlap in English and Albanian. The majority of indefinite pronouns in English are compound and despite implying the plural they are accompanied by the singular. The translation of indefinite pronouns often presents discrepancies, because one pronoun in Albanian might have several translations in English. There are also cases when the translation of Albanian indefinite pronouns in English corresponds to other parts of speech.

Key words: word-formation, indefinite pronouns, Albanian language, English.

1. Hyrje

Në *gjuhën shqipe* përemrat e pacaktuar shfaqen si një grup paradigmatic me tipare kategorialiteti apo të veçanta, me dukuri të shumta leksikore-semantike dhe gramatikore, qoftë nga ana morfologjike, qoftë nga ana sintaksore. Veçoria themelore kuptimore e përemrave të pacaktuar është pacaktuesia. Është përemri që tregon frymorë a sende në mënyrë të pacaktuar ose sasi të pacaktuar të tyre. Ky kuptim shumë i

përgjithshëm i përemrave të pacaktuar ruhet në çdo rrethanë ligjërimi. Këtu ata dallohen nga të gjithë përemrat e tjerë, kuptimi i të cilëve përcaktohet nga konteksti a situata e ligjërimin.

Në *gjuhën angleze* përemrat e pacaktuar janë heterogjenë, përse i përket formës. Ata kanë një sërë tiparesh kuptimore dhe gramatikore. Duke mos patur një referencë specifike, por të përgjithshme, ata karakterizohen si një e tërë. Gjithashtu ata karakterizohen nga funksione që

kanë të bëjnë me shprehjen e sasisë, nga e gjitha (all) në të kundërtën e saj asgjë (nothing).

2. Fjalëformimi i përemrave të pacaktuar në gjuhën shqipe

Përemrat e pacaktuar të shqipes mund të ndahen në dy grupe kryesore: **fjalë të papërngjitura** dhe **të përngjitura**. Në grupin e fjalëve të papërngjitura përfshihen përemra të pacaktuar që janë fjalë të thjeshta si: *kush, një, njeri, pak, shumë*. Këto janë *fjalë të prejardhuara me konversion* nga pjesë të tjera të ligjëratës. Kurse në grupin e fjalëve të përngjitura përfshihen përemra të tillë si *kushdo, askush, akëcili*.

Një pjesë e tyre janë **fjalë të parme**, si p.sh.: *aq, ca, kaq, hiç, një, sa*.

Disa të tjerë janë të formuarë me **konversion**, nga emra, përemra të tjerë ose ndajfolje, si: *kush, njëri, gjë, shumë, pak, mjaft, plot*.

Pjesa më e madhe e përemrave të pacaktuar janë të formuar me **përngjitje**. Në këtë proces shpesh marrin pjesë dy elemente që shfaqin tipare të përemrave. Në këtë grup përemrash të formuar me përngjitje, do të veçonim rastet:

(a) **përemër i pacaktuar + përemri kush**: *gjithkush, gjithsekush, shumëkush, tjetërkush, çdokush, pakkush*.

(b) **përemër i pacaktuar + përemër i pacaktuar**: *çdonjëri, gjithçmos, hiçasgjë, hiçgjë, gjithmbarë*.

Te përemrat *hiçgjëkafshë, hiçgjësend* elementi *hiç* (turqizëm) është bashkuar me përemrat *gjëkafshë e gjësend*, të cilët janë formuar nga përngjitja e togut përkatës (*gjë+kafshë, gjë+send*, ku të dyja gjymtyrët kanë kuptim sinonimik).

(c) Një grup tjetër përemrash kanë në temën e tyre, përveç elementëve të ngurosura edhe një element të llojit të vet, p.sh.: *kushdo, cilido, dikush, ndokush, sekush, askush, asnjë, asgjë, asnjeri*.

3. Klasifikimi i përemrave të pacaktuar

Duke u bazuar në elementin e ngurosur, si element fjalëformues, përemrat e pacaktuar mund t'i klasifikojmë në këto grupe:

(a) Përemra të formuar nga **një element i ngurosur**, i cili qëndron në ballë të fjalës + **një element i dytë që merr trajta eptimore**. Në këtë rrugë ndërtohen një varg përemrash të pacaktuar të lakueshëm.

Elementi i ngurosur mund të jetë:

- **me burim përemëror**: dallojmë këtu përemra të formuar me *akë+kush, akë+cili*, si dhe përemrat *akë+sekush, akë+secili*, te të cilët elementi **akë** është bashkëngjitur drejtpërdrejt me përemrat *sekush, secili*.

- **me burim foljor**: *di, n-do* (e formuar nga përngjitja e formës foljore do me lidhëzën kushtore në), p.sh.: *dikush < di + kush, disa < di + sa, ndoca < ndo + ca, ndokush < ndo + kush, ndonjëri < ndo + njëri, ndonjeri < ndo + njeri*.

(b) Nga **përngjitja** e pjesëzave mohuese **as** dhe **mos** me disa **përemra të pacaktuar**, formohen përemrat e mëposhtëm, që kanë kuptim mohor: *askush, asnjeri, asnjëri, asndonjë, asndonjeri, asndonjëri, askurrgjë, askurrkush, asnjëfarëlloj, mosgjë, moskush, mosnjeri*.

(c) Me **lidhëzën se** formohen përemra të pacaktuar: *se+cili, se+cilido, se+kush*.

(ç) Me **ndajfoljet kurr(ë) dhe rrallë** formohen përemrat e eptueshëm: *kurr + kush, kurr + gjë, rrallë + kush*.

(d) Përemra të formuar nga **një element i ngurosur**, i cili qëndron në ballë të fjalës + **një element i dytë i palakueshëm**. Në këtë rrugë ndërtohen disa përemra të pacaktuar të ngurosur, të cilët i veçojmë si më poshtë: *di + çka, di + ç, se + ç, se + do, kurr(ë) + farë*

(dh) Përemra të formuar nga **përngjitja e një fjale përemërore me një element të ngurosur**. Fjala përemërore merr në këtë rast format e eptimit. Në këtë rrugë formohen përemra të pacaktuar të eptueshëm të formuar nga elementi i ngurosur *do* me burim te veta e tretë e foljes *dua* + një përemër, p.sh.: *kushdo, cilido, secilido*.

(e) Përemra të formuar nga **një element i ngurosur**, i cili ndodhet pas një **elementi tjetër përbërës përemëror i palakueshëm**: *çmos < ç + mos, gjithçmos < gjithë + çmos, çdo < ç + do, çfarëdo < çfarë + do, sedo < se + do*.

(ë) Një grup i këtyre përemrave janë përfutur nga **përsëritja** e të njëjtit emër ose përemër, si p.sh.: *lloj-lloj, shoku-shokun (shoqa-shoqen), njëri-tjetrin*.

4. Fjalëformimi i përemrave të pacaktuar në gjuhën angleze

Rrugët e formimit të përemrave të pacaktuar në **gjuhën angleze** përkojnë me ata të gjuhës shqipe. Disa përemra janë të **parmë** (*each, one, both, either, etc*), disa të **përbërë – përngjitur** (*anyone, nothon, everyone, anybody, etc*), disa të tjerë janë formuar **me konversion** (*several, liitle, most, etc*).

Pjesa dërrmuese e tyre janë të përbërë dhe pavarësisht nga kuptimi i shumësit që japin shoqërohen nga folja në numrin njëjës. Ata formohen nga një mbiemër, ndajfolje etj + one/body. Në përgjithësi këta përemra i referohen frymorëve.

5. Përkime dhe dallime të disa përemrave të pacaktuar në gjuhën shqipe dhe angleze

Në një vështrim të përgjithshëm vërejmë se në **gjuhën shqipe** përemrat e pacaktuar janë më të larmishëm se në **gjuhën angleze**, pasi disa përemrave të gjuhës shqipe shpesh i korrespondon i njëjti përemër në gjuhën angleze.

Në gjuhën angleze përkthimi i përemrave të pacaktuar të gjuhës shqipe nuk korrespondon domosdoshmërisht me përemra të pacaktuar, madje në disa raste fjalët respektive nuk janë fare përemra, por pjesë të tjera të ligjëratës: *Iloj-Iloj = various (adjective)*.

Për shkak të ngjashmërisë së strukturës dhe të funksioneve me emrat dhe mbiemrat, përemrat e pacaktuar në **gjuhën shqipe** kanë tërhequr mjete gramatikore nga sistemi emëror dhe mbiemëror. Këto shfaqje vërehen edhe brendapërbrenda një përemri.

Nga kuptimi, përemrat e pacaktuar janë të shumëllojshëm. Shaban Demiraj pranon heterogjenitetin e këtyre njërive. Ai i trajton këta përemra qoftë nga ana semantike, qoftë nga ajo gramatikore (kategoritë gramatikore të gjinisë, numrit dhe rasës), por edhe të funksioneve. Për të lehtësuar paraqitjen metodike të përemrave të pakufishëm, do t'i ndajmë në tri grupe:

1. Përemra të pakufishëm që tregojnë frymorë, sende në mënyrë të pacaktuar.
2. Përemra të pakufishëm që tregojnë sasi të pacaktuar frymorësh e sendesh.
3. Përemra të pakufishëm me kuptim mohor.

Në gjuhën angleze është shumë e rëndësishme të bëhet dallimi midis përemrave të pacaktuar që

përdoren vetëm në numrin njëjës, vetëm në numrin shumës, ose në të dy numrat, me qëllim që të bëhet përshtatja me formën e foljes gjatë zgjedhimit.

Përemra të pacaktuar që përdoren vetëm në njëjës: *another, anyone, anybody, anything, each, either, no one, neither, nobody, nothing, one, other, someone, somebody, something, everyone, everybody, everything, enough.*

Përemra të pacaktuar që përdoren vetëm në shumës: *both, few, fewer, many, several, others.*

Përemra të pacaktuar që përdoren në njëjës ose në shumës: *all, more, most, none, some, such, any.*

Duke parë përemrat e pacaktuar të vjelur nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* dhe korresponduesit e tyre në *Fjalorin shqip - anglisht* vërejmë se një përemër i gjuhës angleze ka korrespondues të ndryshëm në gjuhën shqipe. Për shembull:

Someone / somebody = Akëcili (a), akëkush, akësekush, çdokush, dikush, ndokush, ndonjëri, njeri, një, njëri/a, sekush, tjetërkush

Nothing = asgjë, asgjëkafshë, asgjësend, gjë, gjëkafshë, gjësend, hiç, hiçgjë, hiçasgjë, hiçgjëkafshë, hiçgjësendi, hiçmosgjë, kurrgjë, mosgjë

Por ka edhe raste kur një përemri të gjuhës shqipe t'i korrespondojnë disa në gjuhën angleze.

Gjithë = all, whole (me prafjalën me), full of, everything, everyone, everybody, each, every

Një = Someone, somebody, something, a kind of, a sort of.

Në **gjuhën shqipe** përemrat e pacaktuar janë të larmishëm. Në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* ka 110 përemra të pacaktuar. Për shkak të rrugëve të shumta të fjalëformimit, përemrat e pacaktuar do të vazhdojnë të pasurohen. Më shpesh përdoren **përngjitja** dhe **konversioni**.

Në **gjuhën angleze** përemrat e pacaktuar janë të paktë (në krahasim me shqipen).

6. Përfundime:

Në **gjuhën shqipe** përemrat e pacaktuar janë më të larmishëm se në **gjuhën angleze**, pasi disa

përemrave të gjuhës shqipe shpesh i korrespondon i njëjti përemër në gjuhën angleze.

Në gjuhën angleze përkthimi i përemrave të pacaktuar të gjuhës shqipe nuk korrespondon domosdoshmërisht me përemra të pacaktuar, madje në disa raste fjalët respektive nuk janë fare përemra, por pjesë të tjera të ligjëratës.

Për shkak të ngjashmërisë së strukturës dhe të funksioneve me emrat dhe mbiemrat, përemrat e pacaktuar **në gjuhën shqipe** kanë tërhequr mjete gramatikore nga sistemi emëror dhe mbiemëror. Këto shfaqje vërehen edhe brendapërbrenda një përemri. Nga kuptimi përemrat e pacaktuar janë të shumëllojshëm.

Në gjuhën angleze është shumë e rëndësishme të bëhet dallimi midis përemrave të pacaktuar që përdoren vetëm në numrin njëjës, vetëm në numrin shumës, ose në të dy numrat, me qëllim që të bëhet përshtatja me formën e foljes gjatë zgjedhimit.

Fjalëformimi paraqitet i larmishëm në të dyja gjuhët. Në **gjuhën shqipe** klasa e përemrave të pacaktuar është shumë e larmishme. Në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* ekzistojnë 110 përemra të pacaktuar. Përngjitja dhe konversioni shfaqin prirje për ta pasuruar akoma më shumë këtë grup përemrash. Në **gjuhën angleze** përemrat e pacaktuar janë të paktë (në krahasim me shqipen).

Bibliografi:

QESKU, Pavli (2002), *Fjalor shqip-anglisht*, EDFA, Tiranë.

DEMIRAJ, Shaban(1986) , “Gramatikë historike e gjuhës shqipe”., UT, Tiranë.

I, A. Sh, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1995), *Gramatika e gjuhës shqipe* Tiranë.

GREENBAUM, S. & QUIRK. R. (1990), *A student’s grammar of the English language*. Longman

HORNBY, A.S. (1988), *Oxford Student’s Dictionary of Current English*, Oxfröd.

HUDDLESTON, R. & PULLUM, G. K. (2002) *The Cambridge grammar of the English language*. Cambridge University Press

KOSTALLARI, A (etj.) (1980), *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (FGJSSH), Tiranë.

LIKAJ. E., (1984) *Analogjia gramatikore në strukturën morfologjike të gjuhës shqipe*. UT, Tiranë

LIKAJ. E. (2006), *Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe*, (Morfologji historike), Tiranë.

LIKAJ. E., (1985), *Çështje të normës morfologjike në gjuhën letrare shqipe: Studime filologjike*, Tiranë, nr. 1.

QUIRK. R. and GREENBAUM. S. (1993), *A University Grammar of English*, Longman Group, England.